

MERRNI E HANI...



MERRNI E PINI...

# Jeta Liturgjike

Viti II Nr. 12, Janar 2006

*Unë jam Bariu i mirë*

# Paqe dhe Bekim për vitin 2006

Në ndërrimin e motmoteve shtetet, organizatat e ndryshme bëjnë llogaritjet rreth të arriturave dhe dështimeve gjatë vitit që e lamë pas. Dhe natyrisht ata bëjnë edhe plane për vitin e ri për të shënuar rezultate më të mira.

Edhe ne si besimtarë duhet të bëjmë një llogaritje të tillë. Ne nuk kemi shumë zgjidhje. Kemi gjithmonë para vetit dy rrugë: Të Zotit dhe të Djallit. Pra, cilës rrugë kam ecur më tepër gjatë vitit të kaluar? Kam bërë më tepër vepra të mira apo të këqia? Kam bërë paqe në rrethin ku jetoj? Kam qenë vigjilent, përgjegjës dhe i ndërgjegjshëm në obligimet e përditshme...?

Çka mund të themi për vitin 2005?

Kisha e Gjithëmbarrëshme

- Viti 2005 i ishte kushtuar Eukaristisë nga papa i ndjerë Gjon Pali II. Ishte ky një rast i mirë që si besimtarë të falenderojmë Zotin për këtë dhuratë kaq të madhe dhe njëherit të kuptojmë se Eukaristia apo Mesha shenjte është burimi dhe forca e jetës sonë shpirtërore.

- Më 2.IV.2005. në Vatikan rreth orës 21 e 30 m pushoi së rrahuri zemra e madhe Papës së Madh Gjon Palit të II. Asnjëherë gjatë historisë nuk ishte shfaqur interesim më i madhë për të marrë pjesë në ndonjë varrim si me këtë rast. Pra, në varrimin e Papës që u bë në Vatikan më 8.IV.2005. në

morën pjesë 4 mbretër, 5 mbretëresha, 70 apo më shumë presidentë (Presidenti amerikan Bush me bashkëshorten dhe prindërit e vet, Klintoni, Karteri). Pastaj për t'i thënë lamtumirën e fundit, në radhë priten edhe me nga 18 orë, kolona e atyre që pritin për të hyrë në Bazilikën e shën Pjetrit ishte e gjatë 5 km. Varrimin e përcollen 3500 gazetarë, 4 milion shtektarë, ndërsa përmesë tv së 3 miliardë njerëz.

- Disa ditë pas vdekjes së Tij, kardinajt zgjodhën papën e ri Josef Ratzingerin, i cili e mori emrin Benedikti XVI. Ai menjëherë lejoi fillimin e procesit për beatifikimin e paraardhësit të vet, Papës Gjon Palit të II.

- Prej 16 21.VIII. në Këln të Gjermanisë nën moton Erdhëm t'i shprehim nderimet tona, u mbajtë Dita Botërore e të Rinjve. Në mesin e qindra mijëra të rinjve ishin edhe



Ngjarjet në Kishën në Trojet shqiptare

- Viti i kaluar ishte vit i jubileve të rëndësishëm. Kështu ne me solemnitet përkujtuam 600 vjetorin e lindjes të Heroit tonë kombëtarë Gjergj Kastriotit. Pastaj 450 vjetorin e librit të parë shqip Mesharit të Gjon Buzukut, 95 vjetorin e lindjes të së pavdekshmës Nënës sonë Tereze, si dhe 100 vjetori i famullisë së Stubllës dhe legalizimi i shkollës së parë shqipe.

- Ditë historike ishte edhe vënia e gurëthemelit të katedralës kushtuar Nënës sonë Tereze, që u bë në Prishtinë më 26.VIII.

- E rëndësishme për Kishën tonë është edhe emërimi i tre ipeshkvijve: Mons Dodë Gjergji, emërohet ipeshkëv i Sapës, p Ottavio Vitale, ipeshkëv i Lezhës dhe p Kristofor Palmieri, ipeshkëv i Rrëshenit, pra në Shqipëri.

- Vitin e kaluar i patëm edhe dy meshtarë të rinjë Don Jeton Thaçi, tani kapelan në Klinë, dhe don Anton Ukaj, kapelan në Velezhë, si dhe tre xhakon të rinjë: Pal Tunaj, nga Zllakuqani dhe vëllëzërit bineç Albert dhe Robert Jakaj.

Ngjarjet në botë

Viti 2005 ishte vitë me shumë viktima të pafajshme. Luftërat e shumëta, aktet terroriste shkaktuan vdekjen e qindra dhe mijëra njerëzve të pafajshëm. Këtu duhet

t'i përmendim edhe katastrofat natyrore. Shkatërrimtar për Amerikën ishte uragani Katrina, që përveq dëmeve materiale shkaktoi më tepër se 1000 viktima. Sivjet erërat e ndryshme arritën shpejtësinë rekorde mbi 280 km në orë. Pati vërshime të shumëta dhe zjarre të ndryshme. Më i tmerrshmi ishte termeti që në vjeshtë goditi Pakistanin dhe Indinë duke shkaktuar vdekjen e rreth 60 mijë personave.

Në faqet e para të Biblës lexojmë se gjithëçka krijoi Zoti ishte e bukur dhe në fund e krijoi njeriun për t'i shijuar të mirat që Zoti i krijoi për të, dhe që ta zotëronte natyrën. Mirëpo, njeriu me egoizmin dhe arritjet e veta po rrezikon ardhmërinë e vet. Natyra gjithnjë po iu hakmirret me katastrofa të ndryshme.

Kështu edhe Papa Benedikti XVI kërkon përgjegjësi më të madhe për të arritur paqen. Ai në porosinë e vet në Ditën Ndërkombëtare të Paqës kërkontë harmonizojmë historinë, drejtësinë, lirinë dhe dashurinë me rendin hyjnorë. Porosia e tij na flet për të këqijat e kësaj bote, duke e propozuar vlerën e paqes si frytë të vërtetës. Nëse njeriu i sotëm dëshiron paqe, duhet vërtet të vlerësojë botën në të cilën jetojmë: Mjerisht bota moderne sot lejon që të vdesin me miliona njerëz nga uria dhe i detyron me

miliona të tjerë të enden për një kafshatë bukë?! Ne jetojmë në një botë me përplot armatim shkatërrimtar. Ne duhet të kuptojmë vrasjen e katërfishtë që e shkakton armatimi: Së pari fakti se buxheti i shteteve kryesisht shkon në armatim, në vend që të shkonë për shendetësi, arsim, ushqim etj. Pastaj rreth armatimit modern punojnë njerëzit më inteligjent. Pra, punohet për vdekje, e jo për jetë. Arma vret kur përdoret për vrasje por edhe për hakmarrje. Ne nuk duhet të mbrohemi me armë, por me drejtësi dhe dashuri. Ai që e gjën Zotin, mbetët në Zotin dashuri, të drejtë dhe të mëshirëshëm, e jo në zotin që vret. Duhet t'i mësojmë njerëzit të kuptojnë se ngadhënjimtarë janë ata që e duan dhe e zbatojnë të vërtetën, drejtësinë dhe dashurinë. Uroj dhe lutem që porosia e Papës të bëhet bukë e përditshme për besimtarët gjatë vitit 2006 dhe për të gjithë që nepërmjet të vërtetës të vijmë deri tek paqja, përfundon komentimin e porosisë së Papës Ernesto Olivero, themelues i Shoqërisë së të Rinjve në Torino.

Ne duke iu bashkangjitur këtij urimi, urojmë që lexuesit tanë të gjëjnë paqe në zemrat dhe familjet e veta. Ju urojmë një vitë të mbarë, frytdhënës, shendet e të mira prej Zotit.

Po ashtu urojmë që viti 2006 të shkruhet me shkronja të arta,

duke hyrë në analet e historisë sonë kombëtare, si vitë i realizimit të ëndërrave tona shekullore, vitë kur Kosova do të pranohet si shtet i pavarur dhe sovran.

Don Albert DEMAJ

## *Kronika*

*25.XII.2005. Krishtlindja u kremtua me solemnitët në tërë Kosovën. Mesha e mesnates nga Prishtina u transmetua edhe nga mediat elektronike. Ne mesin e mysafirve të shumte ishte edhe kryeministri z. Bajram Kosumi me disa ministra. Meshen e udhëheqi ipeshkvi ynë Mark Sopi*

*28.XII.2005. Në Teatrin e Gjilanit u mbajtë Koncerti Tradicional i Krishtlindjes. Morën pjesë koret e famullive të Ferizajit, Stubllës dhe Binçës dhe Kori fëmive Zogjët Këndojnë nga Gjilani.*

*5.I.2006. Në Vau Dejë të Shqipërisë ishte shugurimi ipeshkvorë i Mons Dodë Gjergji, i cili u emërua ipeshkëv i Sapës. Në këtë solemnitët morën pjesë një numër i madh i meshtarëve tanë në krye me ipeshkvin Mons Mark Sopi.*

## *E diela e II gjatë vitit* *Rabbi, ku banon? Ejani e shihni!*

**Leximi i parë:** *1 Sam 3, 3-10.19* Zoti e thërret Samuelin në detyrë të re. Zoti dëshiron që Samuel të bëhet profet, që izraelitëve t'iu përcjellë porosinë e Zotit. Kjo thirrje pak e shqetëson Samuelin, i cili nuk e njeh Zotin. Por ai shpejt përqendrohet dhe jep përgjigje të mrekullueshme: *Fol, o Zot, shërbetori yt dëgjon!* Zoti thërret edhe sot, por shumica prej nesh nuk e japim përgjigjen e Samuelit.

**Psalmi:** *40 (39). Ja, po vij, o Zot, për ta kryer vullnetin tënd.*

**Leximi i dytë:** *1 Kor 6, 13-15.17-20.* Porosia e shën Palit është shumë e qartë por edhe kerkesë e madhe për të krishterët. Le të themi se Korinti në atë kohë ishte një por i madh, ku mjerisht jetohej një jetë e pamoralshme. Shën Pali kërkon që i krishteri me tërë qenien e vet të jetë i kushtuar Zotit...

**Ungjilli:** *Gjn 1, 35 42*

*Në atë kohë, Gjoni ishte bashkë me dy prej nxënësve të vet dhe, kur e pa Jezusin duke kaluar andej, tha: "Qe, Qengji i Hyjit!" Dy nxënësit e tij dëgjuan ç' tha dhe u nisën mbas Jezusit. Jezusi, kur pa se po e ndiqnin, u kthye dhe i pyeti: "Çka kërkon?" Ata i përgjigjën: "Rabbi, (që do të thotë: Mësues), ku banon?" "Ejani e shihni! u përgjigji. Ata shkuan e panë ku banonte dhe atë ditë ndenjen tek ai. Ishte rreth orës dhjetë. Njëri prej atyre të dyve që, kur e dëgjuan Gjonin, u nis mbas Jezusit, ishte Andreu, i vëllai i Simon Pjetrit. Ky më të parin gjeti vëllanë e vet, Simonin, dhe i tha: "E gjetëm Mesinë (që do të thotë: të Shuguruarin)!" Dhe e sollti te Jezusi. Jezusi e shikoi dhe i tha: "Ti je Simoni, biri i Gjonit! Ti do të quhesh Kefë!" (që do të thotë: Pjetër Shkëmb).*

**Fjala e Zotit**

Tema kryesore e leximeve të sotit është thirrja. Zoti vazhdimisht thërret njeriun. Por sa ne dijmë t'i përgjigjemi Atij si Samueli apo

apostujt. Le t'i analizojmë së bashku leximet e sotit. Në leximin e parë të Samuelit profet dëgjojmë për ftesën që ia bën Zoti Samuelit. Profeti është ai i cili ia huazon gojën dhe zemrën Zotit. Ai ndërmjetëson në mes qiellit dhe tokës, ai flet qorton dhe mëson mësimet e Zotit. Kështu Zoti dëshiron që ndër profetë ta zgjedhe edhe Samuelin, të cilin disa herë e thirri, por nuk dinte si të përgjigjej. Përgjigja e saktë dhe kuptimplote e Samuleit duhet të jetë model apo moto e jetës sonë: *Fol, o Zot, shërbetori yt dëgjon!* Kjo përgjigje në historinë e Kishës zënë vendin e parë për të gjithë ata që dëshirojnë të jenë në shërbimin e Zotit dhe Kishës. Sepse ai që dëshiron ta dëgjoj zërin e Zotit për të qenë në shërbim të Tij nuk është tjetër pos shërbëtor, i cili duhet të ketë përvujtërinë, mirësinë, dashurinë.

Ndërsa në leximin e dytë shohim se si shën Pali qorton, mëson dhe orienton popullin e Korintit që mos t'i mbizotëroj fëlligështia. Shën Pali qorton dhe mëson se trupi është gjymtyrë e Krishtit nuk është për fëlligështi, trupi është edhe tempull i Shpirtit Shenjtë dhe ai që shpirtërisht bashkohet me Zotin është një me Të.

Kjo na bënë të vetëdijshëm që të ruhemi prej mëkatit, i cili na robëron dhe shkatërron gradualisht për të na ndarë nga plani i Zotit që të shëlbohem.

Ungjilli i sotshëm po ashtu ndërlihet me leximin e parë që ka kuptim thirrjen. Në këtë pjesë të Ungjillit është pak sa ndryshe. Këtu hapin e parë e marrin tre apostujt të cilët e njohin Qengjin e Hyjit dhe i shkojnë pas. Jezusi i pyet çka kërkon? E ata nuk kërkojnë as shërim, as para, as lavd, por janë të interesuar të dinë ku banon Ai? Edhe pse ishte diçka krejt thjesht vendi ku Jezusi banonte, ajo nuk i

zmbropsi, por edhe më tepër i përforcoi që ky qëndrim një ditor të bëj që t'i bashkëngjitej edhe Simoni shoqërisë së tyre. Në historinë e Kishës nga jeta e shenjtërve kemi plot raste në të cilat shprehet mëshira dhe dashuria e Zotit. Njeriu gabon, mashtrohet, zhytet në mëkat, por në rastin e volitshëm pendohet, kthehet dhe vetëdijesohet për të qenë vegël në duar të Zotit. Në kthimin dhe përmirësimin e jetës je më afër Zotit dhe më afër vëllaut njeri në kuptim të plotë të fjalës. Të jesh në shoqëri me Zotin do të thotë shumë, sepse ti nuk je vetëm, rruga e jote nuk është e pasigurt, qëndrimet tua, por edhe vuajtjet kanë kuptim, edhe më tepër jeta jote është e mbushur me Zotin.

Kjo e diele e ka kuptimin dhe porosinë e qartë. Thirrja që bën Zoti dhe përgjigja e njeriut. Zoti na ka thirr në jetë. Ne jemi në botë pa dashjen tonë. Nuk jemi rastësisht këta që jemi dhe këtë që kemi. Krejt kjo është plani i Zotit. Shën Augustini thotë: *Zoti na ka krijuar pa dëshirën tonë, por Ai nuk dëshiron të na shëlbojë pa bashkëpunimin tonë!*

Andaj si të krishterë të gjithë jemi të ftuarit e Tij që në jetë ta dëshmojmë atë. Besimin tonë që kemi pranuar në pagëzim dhe e kemi përforcuar me sakramentet tjera, ta konkretizojmë në vepra. Kjo është një domosdoshmëri për të krishterë, sepse ai që e kërkon dhe e gjen Zotin, ka gjetur jetën, ka gjetur lumturinë, ka gjetur paqen. Sot ka njerëz në botë që pasurisë nuk ia dinë fundin, por nuk janë të lumtur, sepse iu mungon pasuria më e madhe - Zoti.

Ne si besimtar duhet të jemi të vetëdijshëm të jemi në lidhshmëri me Zotin, sepse jemi të grishurit e Tij në jetë, në punë, në meshtari, në rregulltari dhe në familje. Ky vetëdijesim na mundëson dhe zbulon kuptimin e plot të jetës dhe qëllimin e saj se jemi të krijuar për shëlbim dhe shenjtërim. Mendoj se kjo tregon dhe dëshmon thirrjen tonë për shenjtëri dhe përsosmëri.

Përgjegjësinë për të qenë edukatorë i mirë me vlera të mira fetare dhe kombëtare nuk mund askush ta mohojë dhe ta refuzojë, sepse *familja është një kishëz e vogël*. Në familje fillon edukata, mësimi dhe zbatimi i ligjeve të Zotit, ndërsa të parët në këtë mësim janë prindërit dhe të afërmit.

Shtrohet pyetja: sa prindërit punojnë me fëmijë? Sa ata i mësojnë dhe zbatojnë thirrjen e Zotit që kanë marrë? Të jesh prindër ndër të tjera do të thotë të kesh përgjegjësi. Ne kemi nevojë për familje të mira, të përshpirtshme. Të gjithë duhet të punojmë që ta kumtojmë lavdinë e Zotit dhe me jetë të dëshmojmë se i përkasim Atij.

### *Lutja e besimtarëve*

**T'i lutemi Zotit të mëshirshëm, i cili përkujdeset për popullin e vet, e ruan dhe i ndihmon duke thënë: Dëgjoje, o Zot lutjen tonë**

- Për Kishën tënde të shpërndarë në katër anët e botës, që Ti ta ruash, ta ndihmosh e ta udhëheqësh, *të lutemi*.

- Për paqe në mes njerëzve që ta kuptojnë se të gjithëve na ke krijuar Ti, dhe se ne jemi një familje e madhe e Ti je Ati ynë, *të lutemi*.

- Që sa më shumë djem e vajza ta dëgjojnë thirrjen tënde dhe me gatishmëri të përgjigjen, porsì Samueli, *të lutemi*.

- Për të gjithë ata që kaluan nga kjo jetë tek ti, o Zot, pranojë në mbretërinë tënde, *të lutemi*.

**O Zot, Ti je i mirë dhe i mëshirshëm. Na i fal gabimet tona dhe na ndihmo me hirin Tënd që duke iu përgjigjur thirrjes sate të jetojmë në paqe dhe dashuri. Nepër Krishtin Zotin tonë Amen.**

Don Marjan **DEMAJ**

## ***E diela e III gjatë vitit Kthehuni e besoni Ungjillit!***

Leximi i parë: *Jon 3, 1-5,10* Leximi i parë është shumë seriozë dhe me porosi të madhe edhe për ne. Ne lehtë largohemi nga rruga e Zotit, dhe kemi nevojë për pendesë dhe kthim kah Zoti. Jona Ninivës nuk i sjellë kajme të mira. Ata i pret shkatërrimi, por ata pendohen dhe shpëtojnë nga më e keqja. Zoti nuk është hakmarrës, por njeriu nuk guxon të kënaqet me të keqen e vet.

Psalmi: 25 (24). *M'i mëso, o Zot, shtigjet e tua.*

Leximi i dytë: *1 Kor 7, 29-31*. Shën Pali i thërret korintasit të mos lidhen me të mirat e kësaj bote. I krishteri duhet të dijë edhe të flijojë dhe të agjërojë.

Ungjilli: *Mk I, 14-20*

*Pasi e burgosën Gjonin, Jezusi shkoi në Galile. Atje predikonte Ungjillin e Hyjit. Thoshte: "Koha u plotësua e Mbretëria e hyjit është ngjat! Kthehuni e besoni Ungjillit!" Ndërsa po kalonte bregut të Detit të Galilesë, Jezusi pa Simonin e Andreun, të vëllanë e Simonit, duke gjuajtur peshk ishin peshkatarë. Jazusi tha: "Ejani pas meje e do t'ju bëj peshkatarë njerëzish!" Ata aty për aty i lanë rrjetat e shkuan pas tij. Si eci edhe pak, pa Jakobin e Zebedeun e të vëllanë e tij, Gjonin: ishin në lundër e po armonin rrjetat. Menjëherë i thirri edhe ata. Ata lanë të atin e vet Zebedeun në lundër bashkë me mëditës dhe shkuan pas tij.*

Fjala e Zotit

Ndonjëherë na rastisë që, duke ecur në rrugë, të kuptojmë se nuk jemi në rrugën e drejtë. Atëherë për fat, dkush na tërheq vëmendjen duke na thënë: *Nuk je në rrugën e duhur, ke gabuar*. Ne e falenderojmë dhe e marrim rrugën e duhur,

Si të krishterë ne jetojmë në të njëjtën eksperiencë. Edhe populli i Ninivës ishte në gabim, siç lexojmë në leximin e parë. Atëherë Zoti thërret profetin Jonë: *Çohu, shko në qytetin e madh të Ninivës e kumtoju sa do të të them unë!* Jona u ngrit e shkoi në Ninivë sipas urdhërit të Zotit. Jona predikoi kështu: *Edhe dyzetë ditë e Niniva do të rroposet!* Ninivasit besuan në Hyjin dhe e ndryshuan jetën e tyre të keqe. *Kështu Hyjit i erdhi keq për dënimin me të cilin u ishte kërcnuar se do t'ua çojë dhe nuk ua çoi.*

Edhe në ungjillin e sotëm Jezusi shkoi në Galile. Aty predikonte Ungjillin e Hyjit. Thoshte: *Koha u plotësua e mbretëria është ngjat! Kthehuni e besoni Ungjillit!* Pas këtij apeli për kthim e pendim, Jezusi pa Simonin e Andreun, të vëllanë e Simonit, duke gjuajtur peshk ishin peshkatarë.

Jezusi u tha: *Ejani pas meje e do t'ju bëj peshkatarë njerëzish*. Ata shkuan pas tij. Si eci edhe pak, pa Jakobin Zebedeun e të vëllanë e tij Gjonin. Jezusi i thirri edhe ata. E ata shkuan pas tij. Gjithë kjo eksperiencë (përvojë) na ndodhë neve. Jezusi thërret: Për të ndryshuar jetën tonë, nga e keqja në të mirë, dhe nga e mira tek më e mira. Na thërret për një jetë në dashuri me Atë dhe me të gjithë njerëzit. Na thërret për një jetë më të krishterë dhe më katolike. Si jetojmë ne? Jezusi na thotë: *Kthehuni dhe besoni në Ungjill!* E ne përgjigjemi me fjalët e psalmistit: *Le të bie në mend mëshira jote, o Zot, dhe dashuria e jote që është e amshueshme. Mos i kujto fajet dhe paudhësitë e rinisë sime: le të bie në mend për mua sipas mëshirës sate për hir të mirësisë sate, o Zot!*

Pastaj Jezusi na thërret për ta ndjekur si apostujt e vet. Dhe ne themi *po* dhe shkojmë drejt tij dhe eci me të. Si apostujt e tij, ne flasim me të tjerët, si vetë Jezusi kur fliste në kohën e vet.

Prandaj, mos të harrojmë asnjëherë se Krishti vazhdimisht na thërret edhe për të ardhur në Meshë, në takimin personal me Të. Mos të lejojmë që të mirat e kësaj bote të na ndajnë prej tij, sepse ekziston rreziku të humbasim shumë më tepër se sa ne mund të paramendojmë.

Le të lutemi së bashku që thirrja e Krishtit për të qenë më të mirë, e pse jo ndokush edhe të bëhet apostull meshtarë, të arrijë deri tek zemrat tona dhe atë thirrje ta realizojmë në jetën tonë të përditshme. Amen.

### **Lutja e besimtarëve**

T'i përgatisimi zemrat tona për pajtim me Zotin dhe me të afërmin, sidomos me ata të cilët i kemi fyer gjatë javës së kaluar, kur me fjalë apo sjellje, duke thënë: *Nafal ne, o Zot.*

O Zot, fjala jote për ne është burim gëzimi, pajtimi dhe jete. Na fal për pakujdesin tonë në Kishë, në familje, në shkollë, në shoqëri, *të lutemi.*

- O Zot, ti dëshiron që njerëzit të jetojnë në paqe dhe harmoni. Na fal ngatërresat, fyerjet që ia kemi shkaktuar njëri tjetrit, *të lutemi.*

- O Zot, Ti dëshiron që ne gjithmonë të flasim të vërtetën dhe të jemi të sinçertë me njëri tjetrin. Fali gënjeshtër, shpifjet, dytërishtësi tona, *të lutemi.*

O Zot, fali mëkatet, lëshimet dhe dobësitë tona dhe na ndihmo që kurrë mos të ndahemi prej Teje. Nepër Krishtin Zotin tonë. Amen.

## *E diela e IV gjatë vitit Bëj, o Zot, që ta dëgjojmë zërin tënd.*

**Leximi i parë:** *Lp 18,15-20.* Në këtë pjesë të Shkrimit shenjt dëgjuam fjalët e Moisiut, i cili popullit të vet ia paraqet porosinë e Zotit. Le të themi se profetët në emër të Zotit i flasin popullit, duke e ruajtur besimin e tyre në një Zot dhe duke e nxitur shpresën e tyre në ardhjen e Mesisë.

**Psalmi:** *95 (94) Bëj, o Zot, që ta dëgjojmë zërin tënd.*

**Leximi i dytë:** *1 Kor 7,32-35* Ky lexim na sjellë mësimin e shën Palit mbi shenjtërinë e trupit, të kurorës dhe jetës martesore. Korinti ishte qytet amoral. Andaj nuk ishte e lehtë për shën Palin që në një ambient të tillë t'i predikojë vlerat morale të mësimin të Krishtit mbi martesën gjegjësisht jetës në familje.

**Ungjilli:** *Mk 1, 21-28.*

*Arritën në Kafarnaum. Menjëherë, të shtunën, Jezusi hyri në sinagogë dhe filloi të mësojë. Njerëzit mbetën të habitur nga mësimi i tij, sepse i mësonte si ai që ka autoritet e jo pors i skribët. Shi atëherë ishte në sinagogën e tyre një njeri i pushtuar prej shpirtit të ndytë dhe bërtiti: "Çka ke me ne, o Jezu Nazareni? A erdhe të na zhbish? Unë e di kush je: Shenjti i Hyjit!" Jezusi iu kërcnuu: "Hesht dhe dil prej tij!" Shpirti i ndytë, si e përplasi pa mëshirë dhe si lëshoi një britmë të madhe, doli prej tij. Të gjithë u tmerruan dhe i thoshin njëri tjetrit: "Ç'u bë kështu!? Ja, një mësim i ri i pajisur me psuhtet! Ky u urdhëroka deri edhe shpirttrave të ndytë dhe ata po e dëgjokan!" E menjëherë u hap zëri për të gjithkund në katër anët e krahinës.*

**Fjala e Zotit**

Derisa në leximin e parë fjalën e ka profeti më i madh izraelit - Moisiu, në ungjill si zakonisht i dëgjuam fjalët e mësuesit më të madhë të njerëzimit Jezu Krishtit. Marku ungjilltar shkurtimisht sot na e sjellë paraqitjen dhe efektin e fjalëve të Tij: *Njerëzit mbetën të habitur nga mësimi i tij, sepse i mësonte si ai që ka autoritet, e jo pors i skribët!* Krishti nuk fliste fjalë të kota urtinë njerëzore, por fjalët e Zotit. Porosinë e jetës së amshuar e vërtetonte me fuqinë e fjalës së vet dhe të mrekullive të shumëta. *Ai nuk ka dashur të bëj çka nuk ka qenë, nuk ka kërkuar asgjë çka vet nuk e ka bërë! Jezusi ka qenë çka ka mësuar, dhe ka mësuar atë çka ka qenë!* Shën Augustini.

Çdo i krishterë duhet të jetë ai që dëshmon, dëshmitar i gjallë i besimit në Zotin Dashuri. Me ndihmën e Zotit, i krishteri duhet të jetë shenjë e kohës, nëse me asgjë tjetër, atëherë së paku me jetën e vet. Detyrë e secilit prej nesh është që të jemi së paku një profet dhe mësues i vogël.

E keqja është se ne nuk jemi të tillë. Ne asgjë nuk i flasim botës për mësimet e Krishtit. Ne nuk e deshmojmë me jetë mësimin e tij të mrekullueshëm mbi faljen dhe dashurinë. Mjerisht ne shpesh herë jemi shpirtërisht të vdekur, fantazma... E bota nga njerëzit e tillë s'ka çka dëgjon dhe mëson.

Le të kuptojmë se edhe djalli e njëj Krishtin si Zot, por nuk i beson dhe nuk e do. Pra, mos të krenohemi se ne e njohim Krishtin apo edhe të themi se e duam dhe i besojmë Atij. *Besimi pa vepra është i kotë, i vdekur*, thotë shën Jakobi.

Pra, mos të humbasim kohë, por qysh sot le të vendosim që tash e tutje besimin tonë në Krishtin ta dëshmojmë me fjalë dhe me vepra. Amen.

### **Lutja e besimtarëve**

**E diela na përkujton ngjalljen tënde dhe na dëshmon se Ti je Emanuell Hyji me ne. Pra, ne bijtë dhe bijat e tua të sigurtë se do t'i dëgjosh lutjet tona, të themi: *Na dëgjo, o Zot***

- O Jezu, Ti je drita që erdhi prej së larti në botën plot terrina. Mos lejo të jetojmë në terrin e mëkatit, djallit dhe të vdekjes, por na ndihmo të ndjekim dritën tënde, *të lutemi*.

- Mëkatet tona janë të shumta dhe të shpeshta. Tregoje mëshirën tënde në falje dhe na ndihmo në përmirësimin e jetës sonë mëkatore, *të lutemi*.

- Ji strehimi dhe mbrojtja e të varfërve e na mëso edhe ne t'i njohim, t'i nderojmë, t'i duam dhe t'iu ndihmojmë atyre, *të lutemi*.

- Dëshirat tona të mira mos të mbesin vetëm fjalë apo premtime të kota, por të realizohen me ndihmën tënde, *të lutemi*.

**O Zot, ne po lëshohemi në dorën tënde dhe po të lutemi, ngjallu në jetën tonë, në familjet dhe në popullin tonë. Nepër Krishtin Zotin tonë. Amen.**

Don Kristë **GJERGJI**

## **Shën Sebastijani, martir**

(20.I.)

Sebastiani lindi në Narbon në Gali (Francë) në shekullin e III, por edukohet në Milano. Ai vjen nga një familje e pasur dhe e krishterë. Veç si fëmijë vendosi të bëhet ushtarë, me dëshirë që edhe në ushtrinë e mbretit të përhapë besimin e krishterë. Me trimërinë, sinçeritetin dhe dashurinë e vet arriti të fitojë simpatinë e eploveve dhe të shokëve të vet. Kështu Sebastiani fillojë të krijojë edhe karrierë

ushtarake me shpërblimet e shumëta që i fitonte. Ai u bë udhëheqës i gardes së mbretit. Ai me këtë funksion të lartë kishte mundësi t'i vizitonte të krishterët nepër burgje dhe natyrisht t'i ngushëllonte dhe inkurajonte. Veprimtaria e tij bujare u zbulua shpejt. Sebastianin aspër e qorton mbreti për mosdisplinë dhe tradhëti në shërbim. Por Sebastiani me trimëri i përgjigjet se kurr nuk i ka harruar detyrat e veta dhe se është i gatshëm me vdekë në detyrën e vet. Megjithatë, mbreti e denoi me vdekje. Ushtarët e morën dhe të lidhur për druri filluan të gjuajnë me shigjeta në të. Kështu e shohim edhe nëpër figura. Fatmirësisht Sebastiani nuk vdiq nga këto plagë. Të krishterët e morën dhe ia shëruan plagët. Miqët e këshilluan të largohet prej Romës, por ai nuk pranoi. Haptas e mbronte krishtërimin nepër rrugët e Romës. Një ditë derisa qendronte në dyert e një tempulli ku duhej të vinte mbreti, Sebastiani i tha: *O Mbret, mos lejo të të mashtrojnë më zotat e rrjeshëm! Dije se vetëm lutjet e të krishterëve të ndihmojnë dhe të ruajnë! Diokleciani i habitur e pyeti: A nuk je ti Sebastiani që të kam dorëzuar shigjetarëve? Po, përgjigji me trimëri Sebastiani.*

Diokleciani i mllëfosur urdhëroi ta burgosin dhe ta rrahin deri në vdekje. Sebastiani martir vdiq më 20.I.289.

Sh Masjani, siç themi ne është një ndër ata shenjtër që nderohen më të madhe nga besimtarët. Kështu ai është shumë i nderuar dhe i dashur edhe në popullin tonë. Shumë familje e kanë pajtor të vetin. Në Kosovë sh Masjani festohet në Binçë dhe në Peshter. Së shpejti do të bëhet edhe hapja e kishës në Kravasari (Malishevë) e kushtuar këtij shenjti martirë.

*Shën Sebastiani - lutu për ne!*

Don Kolë **ZEFI**

## Kthimi i Shën Palit, apostull (25 janar)

**Leximi i pare: Vap 22, 3-16** Rrëfimi i Shën Palit për kthimin e tij në krishtërim është tejet i prekshëm, me hollësi dhe përshkrime dramatike, plot me përjetime, ndërrime, bindje, përcaktime, sidomos me thellësi dhe porosi të qartë dhe bindëse. Sauli kishte një plan të saktë dhe të përpiktë: përndjekjen dhe shfarosjen e të krishterëve në Damask. Krishti kishte një planë krej tjetër dhe të posaçëm për Saulin: atë ta shndërronte prej armikut të përbetuar në apostullin e popujve, të mbarë botës.

**Psalmi 116** Është psalmi i falënderimit ndaj Zotit i cili ka mirëkuptim, mëshirë, falje, dashuri për çdo njeri, dhe mu kjo është fuqia jonë, mbështetja dhe bashkëpunimi me Të, që na bënë edhe neve të fortë, të qëndrueshëm, si shërbëtorët dhe bashkëpunëtorët e tij.

### Ungjilli Mk 16, 15-18

*Dilni në mbarë botën e predikoni Ungjillin gjithë njerëzve. Kush do të besojë e do të pagëzohet do të shëlbohet, ndërsa kush s'do të besojë, do të dënohet.*

*Shenjat që do t'i përcjellin ata që do të besojnë janë këto: në emër tim do t'i dëbojnë djajtë, do të flasin gjuhë të reja; /në dorë/ do t'i marrin gjarpërinjtë, e nëse do të pijnë ndonjë send që sjell vdekje, nuk do t'u bëjë keq. Do t'i venë duart mbi të sëmurë, e këta do të shërohen.*

### Fjala e Zotit.

Kjo pjesë ungjillore ka disa porosi thelbore, ndër të cilat spikat urdhëri i

predikimit të Ungjillit të gjithë njerëzve. Edhe mbas dymijë vjete, shumë njerëz ende nuk e kanë njohur Krishtin dhe Ungjillin e tij, e shumë të tjerë, së paku deri diku e njohin, por nuk e jetësojnë, një pakicë, *grigja e vogël* beson dhe dëshmon Ungjillin e Krishtit. Kushti i shëlbimit, sipas fjalëve të Jezusit, është besimi dhe pagëzimi, ndërsa shenjat e atyre që besojnë janë këto: dëbimi i djajëve, njohja dhe folja e gjuhëve të huaja, *imuniteti* edhe para helmimeve dhe shërimi i të sëmurëve.



Çka domethënë kjo për ne sot?

Dëbimi i tundimeve të ndryshme të djallit dhe të botës; njohja dhe përdorimi i gjuhës së re të Krishtit, krishtërimit, asaj të dashurisë, me jetë dhe me dëshmi; ruajtja prej helmimeve shpirtërore dhe morale dhe shërimi dhe mjekimi prej robërisë së djallit dhe mëkatit. Kuptohet se edhe mrekullitë shpeshherë e kanë përcjell dhe përforcuar gjatë shekujve predikimit të apostujve, por edhe të shumë shenjtërve deri në ditët tona.

Mrekullia më e madhe sot do t'ishte kjo: që ne me jetën dhe veprimet tona ta dëshmojmë ndërrimin dhe përmirësimin tonë, e me këtë ta tregojmë praninë dhe risinë e Jezu Krishtit në botën e sotme.

## Jeta dhe biografia e shën Palit

Shën Pali, apostulli i popujve, pa dyshim është një ndër figurat më të mëdha dhe më të rendësishme të krishtërit. Disa shkojnë aq larg sa që e konsiderojnë atë edhe si themeluesin e krishtërit duke e vënë në shqyrtim dhe krahasim edhe me vetë Jezu Krishtin me këto këndvështrime: Jezusi dhe Pali, ose edhe kështu: Jezusi apo Pali?

Jeta e tij e mëparshme si farise zelltar, përndjekës i krishtërit, njohja e Ligjit dhe e botës pagane heleniste dhe romake, kthimi spektakular në krishtërim, veprimtaria e mëvonshme në mbarë botën e atëhershme pagane si dhe martirizimi në Romë, e bëjnë atë vërtet të papersëristshëm dhe të pakrahasueshëm.

Duke studjuar Shën Palin hulumtojmë dhe studjojmë edhe përhapjen dhe zhvillimin e krishtërit jashtë botës hebreje, tejkalimin e kufijve kohor-hapësinor, si dhe realizimin e planit të shëlbimit për mbarë njerëzimin. Me Shën Palin Ungjilli u “bë” prona e njerëzimit, Jezu Krishti fytyra qendrore jo vetëm e historisë së shëlbimit, por edhe e mbarë historisë së njerëzimit.

Për ne shqiptarët Shën Pali ka rëndësi të veçantë, sepse ai dhe nxënësit e tij ishin lajmëtarët e parë të Ungjillit për

paraardhësit tanë Ilirët, kështu që në një mënyrë ai është edhe *Apostulli ynë*.

Sipas të dhënave të historiografisë të hulumtuara deri tani Shën Pali dihet se ka lindur në Tars, por nuk kemi të dhëna të sakta për vitin e lindjes, por vetëm supozime të mbështetura kryesisht në dëshmitë e tija, si dhe në historinë profane. Mendohet dhe supozohet se do të jetë lindur diku rreth viteve 5-10 pas Krishtit.

Sipas të gjitha gjasave kthimi i Shën Palit ka ndodhur diku në dimër të vitit 36, fill pas vrasjes së Shën Shtefnit.

Ja dëshmitë e tija:

*Falënderoj Atë që më dha fuqi Krishtin Jezus, Zotin tonë pse më çmoi të besueshëm duke më thirrur në shërbesë mua, që më parë isha blasfemues, salvues, mujshar /1 Tim 1, 12-13/.*

Në Veprat e Apostujve dëshmon kështu:

*Unë jam hebre, i lindur në Tarsin e Cilicisë, por që u rrita në këtë qytet e të këmbët e Gamalielit u edukova sipa Ligjit të të vjetërve: isha zelltar i Hyjit ashtu sikurse që jeni edhe ju sot e kësaj dite... Ndërsa po udhëtoja dhe po iu afrohesha Damaskut, papritmas, rreth mesditës, prej qiellit më shëndriti një dritë e madhe, unë rashë për dhe dhe e dëgjova një zë që më tha :*

*“Saul, Saul, pse po më salvon?. Unë përgjigja : Kush je, o Zot?. Ai më tha : Unë jam Jezusi, Nazarenasi, të cilin ti e salvon! /Vap 22, 3. 6-8/.*

Në Letrën Filipianëve Shën Pali e përdor një fjalë dhe shprehje tjetër, si mistikët, për ta shënuar dhe shpjeguar zgjedhjen hyjnore si dhe autoritetin e tij të pamohueshëm apostolik të cilin e mori drejtpërdrejt prej Jezusit të ngjallur. *Sepse edhe vetë kam qenë zënë prej Krishtit Jezus /Fil 3, 12/.*

Dërgimin apostolik e vërteton edhe në Letrën e Parë Korintianëve me këto fjalë: *Sepse të shpall Ungjillin nuk është një arsye krenie për mua, është detyrë që më duhet ta kryej: i mjeri unë nëse nuk e predikoj Ungjillin!*“ /1 Kor 9, 16/.

Galatasve iu paraqitet dhe iu shpjegon se kush është kështu:

*Porse, kur Atij, që më zgjodhi qysh në kraharrorin e nënës dhe më thirri me hirin e vet, i pëlqeu ta zbulojë në mua Birin e vet për ta shpallur ndër paganë - unë, menjëherë, pa u këshilluar me asnjë njeri e pa u ngjitur aspak në Jerusalem te ata që para meje ishin apostuj, shkova në Arabi dhe përsëri u ktheva në Damask. E vetëm pas tri vjetësh u ngjita në Jerusalem, për t'u njoftuar me Kefën e ndeja te ai pesëmbëdhjetë dite / Gal 1, 15-18/.*

Rreth kthimit të tij ka llojlloj interpretime dhe shpjegime. Disa

flasin për vegim, të tjerët për përjetim mistik personal. Rreth kthimit të Shën Palit është shkruar dhe diskutuar shumë gjatë shekujve e deri në ditët tona. Interpretimet janë të ndryshme. Mirëpo shumica, mos të them gati të gjithë, pajtohen së paku në disa elemente themelore: vegimi që e pati gjatë udhëtimit për Damask, ku iu zbulua Biri i Hyjit / Gal 1, 16/, gjë kjo që pati si pasojë ndriçimin hyjnor / 2 Kor 4, 6/, dhe me këtë Jezusi e bëri atë për vete /Fil 3, 12/.

Mësimet e Shën Palit shpeshherë janë nga brendia e tij mistike, nga drita e brendshme, dhe për ta kuptuar së paku deri diku, duhet të shkojmë deri te burimi i shpirtit dhe jetës së tij.

Pali deri diku i mbetet besnik Besëlidhjes së Vjetër, hebraizmit, së paku në karakteristikat themelore si monoteizmi, tradita e të parëve, sidomos Biblës, Fjalës së Zotit, si dhe shkollës rabine, por gjithnjë nën dritën e krishtëritimit dhe sipas përvojës së takimit me Jezu Krishtin e ngjallur. Kështu të vërtetat hebraike kanë një trajtë dhe përmbajtje tërësisht të re: Hyji është Ati i Zotit tonë Jezu Krishtit; Ngjallja e Krishtit është ngjarja kryesore e mbarë historisë, në veçanti e historisë së njerëzimit, dhe në Të plotësohet Ligji dhe profetët, zbatohen premtimet mesinike, na dhurohet të gjithëve shëlbimi.

Me këtë Pali bëhet apostull i Jezu Krishtit për mbarë botën e atëhershme.

Është mjaft vështirë të jipet profili i personalitetit të Shën Palit, sepse pas takimit me Jezusin e ngjallur në rrugë për Damask /Vap 22, 6/, ai përqendrohet tërësisht në Jezu Krishtin e ngjallur, dhe në prizmen e këtij përjetimi dhe takimi vështron çdo gjë. Nga elementet e pakta që i ka shënuar dimë këtë:

Shën Pali ishte i lindur në Tars në Cilici /Vap 21, 39/, ishte hebre i diasporës me prejardhje nga fisi i Benjaminin /Rom 11, 1/, disa vite më i ri se Jezusi. Kishte nënshtetësinë romake /Vap 16, 37/, gjë kjo që dëshmon se familja e tij ishte e njohur dhe e pasur. Emri i tij hebraisht ishte Saul, kurse latinisht apo në trajtën romake Pal/ Vap 13, 9/. Edukimi i tij fetar ishte mjaft i rrebtë /Fil 3, 5-/, dhe qysh nga fëmijëria e kishte për mësues rabinin Gamalielin, kështu që ishte një farize mjaft i zellshëm /Vap 22, 3; Gal 1, 14/. Nga kjo shihet se ishte njohës mjaft i mirë i ligjit hebre, mendimeve dhe interpretimeve rabinike dhe i përshpirtërisë hebraike.

Pasi ishte qytetar i Tarsit, qytet bregdetar dhe lima, pati mundësi ta mësonte mjaft mirë gjuhën dhe kulturën greke, por edhe të njihje mirë traditën dhe kulturën e

Perandorisë romake. Përpos kësaj merrej edhe me prodhimin e tendave, punë kjo që e kishte vazhduar edhe si apostull i Jezu Krishtit /Vap 18, 3/. Sa i përket shëndetit, sa duket ishte pak i sëmurë, por nuk dihet saktësisht se çfarë sëmundje kishte /Gal 4, 13; 2 Kor 12, 7/.

Pas takimit me Jezusin dhe kthimit në krishtërim shkoi në Arabi /Gal 1, 17/, nuk e dimë me siguri se ku, por mendohet dhe supozohet se ishte ndoshta në ndonjë qytet në afërsi të Damaskut. Pastaj kthehet në Damask, dhe pas 3 viteve iku prej hebrejve /Vap 9, 24/ dhe shkoi në Jerusalem, ku edhe u takua për herë të parë me Shën Pjetrin. Disa vite i kishte kaluar në Siri dhe në Cilici /Gal 1, 18-21; Vap 9, 30/.

Veprat e Apostujve na flasin për udhëtimet e tija, por si qëllim nuk e kanë kronologjinë dhe saktësinë e ngjarjeve, më tepër porosinë dhe veprimin e Shpirtit Shenjt nëpërmjet predikimit dhe veprimeve të Shën Palit.

## Don Lush

*Impresum: Ad usum Internum*  
 Boton: Dekanati i Prishtinës  
 Adresa: Rr. "Rexhep Bislimi"  
 Nr.50, Ferizaj. Tel: 0290/20 041  
 E-mail: jetaliturgjike@hotmail.com  
 Shtypi: "ERA" Ferizaj



## Shën Gjon Bosko, miku i madh i të rinjve (31.I.)

Lindi më 16.VIII.1815. në Becchi (afër Torinos Itali), nga prindërit Franë dhe Margareta Bosko. Ende pa i mbushur dy vite, i vdesë baba, duke i lënë jetima Antonion, Jozefin dhe Gjonin. Gjoni qysh si fëmijë kishte ndjenja për lutje, përshtirë të jashtëzakonshme. Kështu ai në moshën nëntë vjeçare ëndërron se si Zoti kërkon prej tij të merr në kujdesë rininë e rrezikuar nga e keqja. Gjoni qysh në rininë e vet të herëshme vendosi të bëhej meshtarë. Për të realizuar dëshirën e vet jetësore, Gjon Bosko, hynë në seminar më 1835 në Chieri. Shumë shpejtë i përvetësoi rreth vetit të gjithë, edhe atë me zgjuarsinë, zemërgjerësinë e mbi të gjitha me dashurinë e vet.

Më 19.III.1841. shugurohet për xhakon, ndërsa për meshtarë më 5.VI.1841. Menjëherë fillon punën e vet pastorale duke u vënë në shërbim të të rinjve që janë lënë rrugëve. Kështu ai shkante nepër rrugët e Torinos për t'i kërkuar këta të rinjë. Don Gjoni i ri e kuptoi se këta të rinjë jetojnë në një gjendje të tillë sepse nuk ka kush të kujdeset për ta dhe t'i udhëzojë në jetë. Dashuria e tij dhe mirësia atërore shpejt i përfitoi zemrat e tyre. Buzëqeshja e Gjonit shpejt tërhiqte të rinjtë si magnet. Kurrë nuk e kishin monotone shoqërinë e tij, shtyheshin rreth tij dhe e dëgjonin më endje. Zemra e Gjonit ishte e hapur për të gjithë. Ai luante, këndonte, shëtiste dhe lutej me ta. Numri i të rinjve rritej çdo ditë. Don Gjoni me angazhimet dhe përkrahjen e miqëve arriti ta ndërtojë një internat ku të rinjtë kishin mundësi më të mira të edukimit dhe shkollimit. Në kuadër të këtij internati e ndërtoi edhe një kapelë. Numri i të rinjve arriti në 700. Ai tani

shpesh herë kishte probleme ekonomike, kështu që ishte i detyruar të kërkojë lëmoshë. Tani në mesin e këtyre të rinjve lajmëroheshin edhe thirrjet e para meshtarake. Kështu Don Gjoni Bosko më 18.XII.1859 edhe zyrtarisht e hap Kongregatën e Salezianëve. Rol të rëndësishëm në jetën e Don Gjonit kishte rrefimi i shpeshhtë dhe kungimi. Ai në këtë frymë i edukonte edhe të rinjtë që bëheshin qytetarë dhe besimtarë shumë të mirë.

Përndryshe sistemi i edukimit të tij ishte ky: Zhvillimi i plotë i personit; formimi i respektit; të drejtat dhe liritë njerëzore; zhvillimi i aftësive për jetën socialo pastorale; përfitimi i zakoneve intelektuale dhe atyre të punës; përgjegjësia morale dhe edukative në besim dhe shoqëri.

Zoti e bekoj me të madhe punën e frytshme të don Gjonit. Deri te vdekja e tij nepër duart e don Gjonit kaluan 300.000 të rinjë, prej tyre 6000 janë bërë meshtarë, 13 u bënë ipeshkvijë e dy kardinaj. Meshën e fundit e tha më 4.XII.1887. Ai vdiq në mengjesin e 31 janarit të v 1888. duke ia dorëzuar shpirtin e vet fisnik në duart e Atit të vet qiellorë. Shenjtë e shpalli papa Piu XI.

Le të themi se salezianët punojnë edhe në Prishtinë ku përveq famullisë e kanë edhe një qendër të mrekullueshme *Qendra Don Bosko*, që sherben për edukimin dhe aftësimin profesional të të rinjve. Qendra të tilla kanë edhe në Tiranë dhe në Shkodër.

Salezianët shqiptarë janë Imzot Zef Gashi, don Nosh Gjollaj, don Izidor Llukiq, don Domenik Qerimi, dhe don Lekë Oroshi.

## A e dini se...

*Monumentet e rëndësishme të njerëzimit janë*

- Akropoli Kjo gërmadhë gjendet në një kodër në qendër të Athinës në Greqi. Partenonitempulli i ndërtuar për nder të perëndeshës Athinës, është ndërtuar para 2000 viteve. Gërmadhat e saj ende mund të shihen.

- Aihambra Ky pallat gjendet në Granadë të Spanjës dhe është ndërtuar nga maurët, një popull zezakësh nga Afrika Veriore, që e ka qeverisur Spanjën për një kohë të gjatë.

- Gardhi i Australisë Është gardhi më i gjatë në botë. Është ndërtuar nga barinj të vendas, të cilët janë munduar që t'i parandalonin dingot (qentë e tërbuar), që mos t'i sulmojnë delet nëpër kullosa.

Koloseumi Është një stadium ose teatër i hapur që gjendet në Romë. Është ndërtuar në kohën romake, ku luftonin gladiatorët. Ky teatër mund t'i nxente rreth 70 mijë vet dhe në rast të shiut mund të mbulohej. Në këtë teatër shpesh herë para egërsirave i hudhnin të krishterët. Derisa egërsirat i shqyenin të krishterët e

pafajshëm, masa aplaudonte!  
Kulla e Ajfelit Kjo strukturë e hekurt është simbol i Parisit dhe i Francës. Është ndërtuar më 1889 dhe është e lartë rreth 250 metra. E ka marrë emrin në bazë të inxhenierit që e ka projektuar Aleksander Gustav Ajfel.

Muri kinez Është objekti vetëm i ndërtuar nga njeriu dhe që mund të shihet nga hëna. Është i ndërtuar para më se 2000 vitesh për ta mbrojtur Kinën nga pushtuesit. Dimensionet: i gjërë 4 m. i lartë 8 m. dhe i gjatë 2400 km.

Taxh mahall Kjo muranë e bukur dhe e bardhë është ndërtuar në shek. XVII nga Perandori i Indisë, për nder të gruasë së tij të dashur që kishte vdekur. Njëzet mijë njerëz, njëzet vjet punuan për ta ndërtuar këtë objekt imponant, që llogaritet si më i bukur që ka ndërtuar njeriu ndonjëherë.

Pirgu i pjerrtë i Pizës

Është një ndertesë 60 m e lartë, e ndërtuar në Pizë para 7 shekujsh. Ka filluar të lakohet menjëherë qysh gjatë ndërtimit. Ajo ishte paraparë për këmbanë, por ato nuk tingëlluan asnjëherë nga kjo



*Shën Sebastiani - Lutu për ne!*